Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					

TVSH (%)	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

SPECIFIKIME TEKNIKE TË MATERIALEVE

1 - Allçi

Allçia është material që përdoret për përgatitjen e llaçeve të suvatimit, stukimit dhe patinimit. Allçia duhet të plotësojë kërkesa sipas STASH 533-82, konkretisht:
Koha e fillimit të ngrirjes 4÷6 minuta; Koha e mbarimit 6-30 minuta; Mbetja në sitë 8%.

2 - Astari

Astari është material i përdorur përpara lyerjes me hidromat apo bojë hidroplastike. Në rastin e lyerjes me hidromat është gëlqere e holluar me ujë, dhe në rastin e lyerjes me bojë hidroplastike vinovil i holluar me ujë.

3, 4, 5 - Betoni C 7/10, C 12/15, C 16/20

Betonet duhet të plotësojnë standartet sipas STASH 561-83,

Beton C 7/10 me inerte, konsistencë 3 ÷ 5 cm, zhavorr 1.05 m³: Çimento C 30/37, 240 kg; ujë 0,19 m³.

Beton C 12/15 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento C 30/37, 240 kg; rërë e larë 0,45 m³; granil 0,70 m³; ujë 0,19 m³.

Beton C 16/20 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 260 kg, rërë e larë 0,44 m³, granil 0,70 m³, ujë 0,18 m³.

Inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet të perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 “Inertet e betonit nga burime natyrale”. Ato duhet të jenë të fortë dhe të qëndrueshëm dhe nuk duhet të përmbajnë materiale të dëmshme që veprojnë kundër fortësisë ose qëndrueshmërisë së betonit ose, në rast të betonarmesë mund të shkatërrojë këtë përforcim.

Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M250) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave te demtuese. Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%

Inertet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjere ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %..

6 - Binar druri

Binarët e drurit janë elemente çatie me përmasa 6 x10 cm.

Këto elemente druri prodhohen sipas STASH 701-80

7 - Bitum M3

Kërkesat teknike të bitumeve janë sipas STASH 584-84. Bitumi është kërkuar të përdoret me destinacion h/izolim tubacioni, dhe si i tillë është bitum naftor i oksiduar, kërkesat teknike kryesore janë:

- Viskoziteti në 25° C është BL 350-700
- Pika e flakërimit në enë të hapur 90° C
- Përçindja e distilatit deri në 360° C është 0.5

8 - Blloqe betoni

a. Blloqet me brima janë të parapërgatitura. Blloqet nga një prodhues i aprovuar duhet të shoqërohen me certifikatën e prodhimit. Derdhja e blloqeve duhet bërë në kallëpe në përmasat e kërkuara, si dhe të ngjeshet mirë betoni me anë të vibratorit.

b. Përbërja dhe përzierja: Përbërja e blloqeve çimento Portland e zakonshme dhe agregatët e tjerë me cilësi të aprovuar të imët dhe të ashpër me maksimumin e kokrrizës 10 mm; përzierja për blloqet që do të përdoren për mure duhet të jetë 1: 2: 4, sasia e çimentos nuk duhet të jetë më pak se 225 kg për një metër kub të betonit.

c. Rezistenca e blloqeve duhet të jetë: për blloqe me boshllëqe 7 N / mm²; për blloqe solide 10 N / mm²; për blloqe me brima 5 N / mm².

9 - Bojë antiruxho

Boja antiruxho është zmalto alkide që përdoret për lyerjen e sipërfaqeve prej metali, e cila siguron mbrojtje nga korrozioni. Duhet të ofroje një mbulim dhe nivelim të përsosur, tharje të shpejtë, ngjitje shumë të mirë me sipërfaqen si dhe rezistencë të lartë ndaj agjentëve atmosferikë dhe kimik. Mbulimi: për mbulim të plotë 12-14 m²

Hollimi: Me 25% brenda 8 orësh

Koha e tharjes: Koha e plotë e tharjes 30 min; Dora e dytë 16 orësh

10 - Bojë hidroplastike importi

Bojë plastike duhet të jete e cilësisë së lartë për përdorim të brendshëm, me punueshmëri e shkëlqyeshme dhe mbulim i sipërfaqes, si dhe rezistencë të lartë ndaj vjetërimit dhe larjeve të shpeshta. Duhet të ofroje ngjitje të fortë ndaj çdo lloj sipërfaqeje të vjetër ose të re, si suva, beton, kartonxhes etj. Nuk duhet të përmbaje amoniak dhe te ofroje rezultat të shkëlqyeshëm dhe përfundimtar mat. Hollohet me 10-15% uje te paster.

- Ngjyra : E bardhe

- Niveli shkelqimit : Mat

- Mbulimi : Mbulon 12 m² / l, në sipërfaqet e përgatitura më parë.

- Hollimi : Me 10-15% uje te paster.

- Koha e tharjes : Koha e rilyerjes: 3-4 ore (ne kushte atmosferike te pershtateshme) Per ta prekur: 1 ore Tharja e plote

11 - Bojë çimentato

Bojë çimentato është bojë akrilike me bazë uji me cilësi të lartë, e formuluar posaçërisht për aplikim të drejtpërdrejtë në beton, suva, tulla dhe sipërfaqe të tjera murature alkaline.

Ai siguron fuqi të madhe fshehjeje, shkallë të lartë të përhapjes dhe rezistencë të jashtëzakonshme ndaj larjes dhe kushteve të pafavorshme të motit. Koha e tharjes sipërfaqësore 30-60 min

Përqindja e hollimit të ujit 0-10%; Shpejtësia e përhapjes 12-15 m² / lit; Aplikohet me furçë, me rul, me pistolet spray.

12 - Bojë vaji

Boja e vajit është zmalto alkide që përdoret për lyerjen e sipërfaqeve prej metali, e cila siguron mbrojtje nga korrozioni. Duhet të ofrojë një mbulim dhe nivelim të përsosur, tharje të shpejtë, ngjitje shumë të mirë me sipërfaqen si dhe rezistencë të lartë ndaj agjentëve atmosferikë dhe kimik.

- Mbulimi: për mbulim të plotë 12-14 m²

- Hollimi: Me 25% brenda 8 orësh

- Koha e tharjes: Koha e plotë e tharjes 30 min; Dora e dytë 16 orësh

13 - Çelësa brenda murit

Playbus Rangë GW 30011. Çelësat duhet të jenë të tipit të ndërprerjes së ngadaltë “quick make slowbreak” të projektuara për kontrollin e rrjetit AC. Çelësat mund të jenë të tipit “broad rocker”,

për të dhënë njësi të fishuara çelësash që nevojitet. Të gjitha çelsat on/off, të thjeshtë, devijat apo inverter si dhe pulsantet e komandimit janë 10A, 220V.

14 - Çimento ndërtimi

Kërkesat për të dhënat teknike të çimentos për shtypjen, tërheqjen dhe kohën e prezës janë sipas STASH 501-83.

Marka e çimentos portland, rezistenca në shtypje matet mbas 28 ditësh. Për çimento të markës 300 bar duhet të jetë 200 në shtypje dhe 15 në tërheqje dhe për markën 500 bar rezistenca në shtypje duhet të jetë 380 dhe ajo në tërheqje 23 . Fletët e analizave të fabrikave duhet të shoqërojnë çdo dërgesë duke vërtetuar që çimentoja, e cila shpërndahet në shesh ka qenë e testuar dhe i ka plotësuar kërkesat e përmendura më lart.

15 - Dërrasë armatimi

Dërrasat e armaturës prodhohen në përshtatje me kërkesat e STASH 701-80 dhe 744-82. Dërrasat prodhohen me gjatësi $0.5 \div 6$ m, me trashësi mbi 30 mm deri 50 mm.

Këto dërrasa do të ndërtojnë kallëpin, i cili duhet të ndërtohet me vija që mbyllen lehtësisht për largimin e ujit, materialeve të dëmshme dhe për qëllime inspektimi, si dhe me lidhësa për të lehtësuar shpëputjen pa dëmtuar betonin. Të gjitha mbështetëset vertikale duhet të jenë të vendosura në mënyrë të tillë që mund të ulen dhe kallëpi të shpëputet lehtë në goditje apo shpëputje.

Duhet të jetë i fortë, rigjid përkundrejt betoneve të lagët, vibrimeve dhe ngarkesave të ndërtimit dhe duhet të mbetet në përshtatje të plotë me skicën dhe nivelin e pranuar përpara betonimit. Ajo duhet të jetë siç duhet i papërshtetshëm nga uji që të sigurojë që nuk do të ndodhin “disekuilibra” ose largimin e llacit për ne bashkimet, ose të lëngut nga betoni. Druri (dërrasa) i armaturave nuk duhet të deformohen kur të lagen. Për sipërfaqe të paeksponuara dhe punime jo fine, mund të perdoret dërrasa armature e palemuar. Në të gjitha rastet e tjera sipërfaqja në kontakt me betonin duhet të jetë e lëmuar (zduguar). Druri duhet të jetë i stazhionuar mirë, pa nyje, të çara, vrima të vjetra gozhdash dhe gjëra të ngjashme dhe pa material tjetër të huaj të ngjitur në të.

16 - Dritare duralumini

Furnizimi dhe vendosja e dritareve, përbëhen nga material alumini, profilet e të cilit janë sipas standarteve Europiane EN 573-3 dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Korniza fikse e dritares do të ketë një dimension $61 \div 90$ mm. Ato janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesoret e saj. Profili i kanatës së dritares do të jetë me dimensione të tilla 25 mm që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur.

Profilet e kornizave të lëvizshme kanë një dimension: *gjerësia 32 mm dhe lartësia 75 mm* të sheshta. Profili është projektuar me një pjesë boshllëku qëndror për futjen e një mbështetëse lidhëse këndore (me hapësirë 18 mm të lartë nga xhami i dritares) dhe trolleys për rrëshqitjen e tyre. Ngjitja është siguruar nga furça me një fletë qëndrore të ashpër. Profilet e aluminit do të jenë të lyera sipas procesit të pjekjes lacquering. Temperatura e pjekjes nuk duhet të kalojë

180 gradë, dhe koha e pjekjes do të jetë më pak se 15 minuta.

Trashësia e lacquering duhet të jetë së paku 45 mm. Pudrosja e përdorur do të bëhet me resins acrylic të cilësisë së lartë ose me polyesters linear. Spesori i duraluminit duhet të jetë minimumi 1,5 mm. Panelet e xhamit (4 mm të trasha kur xhami është transparent). Ato do të jenë të fiksuara në skeletin metalik me anë të listelave të aluminit në profilet metalike të dritares dhe të shoqëruara me gomina.

17 - Dyer duralumini

Dyert e brendshme prej duralumini do të përbëhen nga:

- Kasa fikse në formë profilesh tubolare prej duralumini me thellësi 61-90 mm, të cilat sigurohen me elemente të posaçëm për fiksimin dhe mbërthimin në strukturat e mureve.

- Profilet fikse të kasës do të jenë me një mbulesë jo më e vogël 25 mm larg murit.

- Kanata lëvizëse në formë profili duralumini me një thellësi prej 32 mm dhe një lartësi prej 75 mm i rrafshët.

- Profili duhet të jetë me një hapësirë qendrore që nevojitet për futjen e bashkuesve të qosheve (me hapësirë prej 18 mm për vendosjen e xhamit) dhe rrulat për rrëshqitjet e tyre.

- Panelet e xhamit të cilat mund të jenë transparente (4 mm trashësia minimale) dhe me mbulesa prej druri të laminuar MTP me trashësi minimale prej 1 cm.

Një bravë metalike dhe tre kopje çelësash tip sekret, doreza dyersh dhe dorezë shtytëse të derës duhet të vendosen si pjesë përbërëse e derës.

18 - Gaz i lëngshëm

Gazi i lëngshëm (GNL) në përbërje është gaz natyral i lëngëzuar në $(-162)^{\circ}\text{C}$, i cili ka një përdorim të gjerë. Kryesisht, për industrinë nevojitet dhe përdoret një përzierje propan - butan.

GNL duhet të ketë këto karakteristika:

- pesha specifike në 20°C : $0.4 \div 0.7 \text{ gr/cm}^3$

- pika e flakërimit: $\text{max.}(-74)^{\circ}\text{C}$

19 - Gëlqere

Kërkesat teknike të gëlqeres jepen në STASH 502-81 dhe metodat e provave në STASH 555-81, të cilat kanë të bëjnë me sasinë e kalciteve, magnezitit, dalja e qullit për kg gëlqere të pashuar, etj.

20 - Gozhdë

Gozhdët, si material metalik lidhës do të jenë në përmasa deri në 20 cm, do të përdoren në punime kryesisht druri. Gozhdët duhet të jenë të qëndrueshme ndaj deformimeve dhe korrozionit.

21 - Gozhdë betoni

Gozhdët e betonit bëjnë të mundur lidhjen e konstruksioneve të ndryshme në mes vete.

Gozhdët e thjeshta preferohet të përdoren për lidhjen e konstruksioneve të betonit. Ato duhet të variojnë me gjatësi deri në 10 cm. Gozhdët duhet të jenë të qëndrueshme ndaj deformimeve dhe agjentëve atmosferikë.

22 - Gozhdë me gominë për llamarinë

Vidat e llamarinës janë prej metali dhe përdoren për lidhjen dhe fiksimin e materialeve metalike. Gjatësia varion nga 3.2 cm deri në 22 cm.

Të jenë rezistence dhe të sigurojnë lidhje të qëndrueshme. Është domosdoshmëria prania e gominës.

23 - Gurë kave

Gurët duhet të merren nga gurore të specializuara për prodhimin e tyre dhe duhet të plotësojnë kërkesat: Dimensi variabël

Gurët duhet të kenë fortësi të madhe, të plotësojnë tërësisht kushtet teknike për rezistencën ndaj ngrirje/shkrirjeve dhe prishjes së strukturës. Karakteristika teknike minimale:

- Rezistencë në ngrirje: Po
- Rezistencë ndaj kushteve klimaterike dhe rrezatimi: Po
- Rezistencë ndaj zjarrit: Po

Gurët, para vendosjes së tyre, duhet të kontrollohen paraprakisht që të mos kenë mbeturina llaçi apo dheu, plasaritje prej ngarkesave që mund të kenë patur në gurore, ngricave apo të shkaktuara gjatë transportit të tyre. Mostrat e gurëve duhet të shoqërohen me të dhëna për prodhuesin apo furnizuesin e tyre. Gurët, gjatë kohës së punimeve duhet të ruhen në vende të thata dhe që sigurojnë mbrojtjen e tyre nga dëmtime mekanike apo nga ngricat.

24, 25 - Hekuri i betonit & 28 - konstruksione metalike

Shufrat e armimit duhet të kthehen sipas masave dhe dimensioneve të vizatimeve, dhe në përputhje të plotë me rregulloren e, rishikuar së fundi të ASTM, shënimi A-615 me titullin “Specifikimet për shufrat e hekurit për betonarme”. Ato duhet të përkulen në përputhje me vizatimet e ASTM A-305, Çelik 3 me sigma të rrjedhshmerisë 250 kg/cm^2 .

Hekuri i armimit duhet të jetë pa njolla, ndryshk, mbeturina të mullinjve, bojëra, vajra, graso, dherave ngjitëse ose ndonjë material tjetër që mund të dëmtojë lidhjen midis betonit dhe armimit ose që mund të shkaktojë korrozion të armimit ose shpërbërje të betonit. Prodhimi i çelikut duhet të jetë bërë nga kompani të licensuara dhe ata duhet të garantojnë për cilësinë si dhe të dhënat (përbërja kimike, karakteristikat e forcës/bajtëse, etj) e çelikut. Çeliku që përdoret për konstruksionet mbajtëse, duhet t’u përgjigjet kërkesave të standarteve dhe kushteve teknike përkatëse dhe të ketë garanci përse i përket kufirit të rrjedhshmërisë dhe përmbajtjes max. të squfurit dhe fosforit; kurse për konstruksionet e salduara, edhe për përmbajtjen max. të karbonit.

26 - Karton katrama e graniluar

Katramat i graniluar është një membranë hidroizoluese prej bitumi me cilësi të lartë të modifikuar me polimere dhe të përforcuar me poliester ose tekstil me fije qelqi me trashësi të ndryshme dhe granil. Dendësia : 4 kg/m^2 dhe Trashësia: 4 mm. Katramati duhet të plotësojë këto kushte:

Raporti në mes të masës impenjuse dhe kartonit të thatë në h/izolim 1,15:1

Rezistenca në tërheqje jo më pak se 32 kg/cm²

Kur mbështillet rreth një tubi me diametër 15÷30 mm, në temperaturën 18° C nuk duhet të plasaritet.

27 - Kol

Duhet të jetë i pajisur me një aftësi optimale ngjitëse në çdo lloj suporti tradicional, si dhe të gëzojë karakteristika të mira të papërshkueshmërisë nga uji. Të lejojë aplikimi në shtresa deri në 5 mm, fortësim uniform, pa tkurrje dhe gropëzim të shtresës. Duhet të jete i klasifikuar sipas EN12004, kategoria C1. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave prej qeramike, gresporcelan dhe dysheme me bazë çimento, për ambjente të jashtme dhe të brendshme.

Djegshmëria : 0, Raporti i përzierjes : 6.5÷7 litra ujë për 25 kg; Masa volumore e përzierjes: 1.83 gr/cm³; pH : 12, Temperatura : 5 gradë deri në +35 gradë; Deformueshmëria : 0;

Forca ngjitëse në beton: $\geq 1.5 \text{ N/mm}^2$; Forca ngjitëse pas veprimit të nxehtë- : $\geq 1 \text{ N/mm}^2$, Rezistenca në shtypje : $\geq 10 \text{ N/mm}^2$; Konsumi : 3÷5 kg/m²; Kalueshmëria: pas 24 orësh.

29 - Kuadër ndriçimi

Kuadri i ndriçimit 24 Module (KN-1/24M, të jetë i pajisur me:

- Rële diferenciale (3P+N) 32 A copë 1(një);
- Lampa sinjalizuese 6 W copë 3(tre);
- Limitator (1P+N) 20 A copë 3(tre);
- Limitator (1P+N) 16 A copë 3(tre)

30 - Kulmore llamarine

Kulmoret e llamarinës janë elemente mjaft të rëndësishëm të çatisë mbuluar me llamarinë të valzuar, që realizon mbulimin e saj në kulm. Ka të gjitha të dhënat teknike të llamarinës së valëzuar, përveç përmasave dhe formës së saj trekëndore, në profil, në përshtatje me funksionin. Përmasat e krahëve janë 30 cm dhe gjatësia 3 m.

31, 32, 33 - Llaç bastard M-25, M-15, Llaç çimentoje M-25

Kërkesat teknike të llaçeve janë të bazuara në STASH 510-81, konkretisht:

Rezistencë në shtypje dhe konsistenca, e cila është e ndryshme në varësi të destinacionit. Metodika e provave jepet sipas STASH 543-83.

Llaçi të ketë konsistencë 70÷90 mm dhe të ketë markë M-25.

Përbërësit:

Llaç bastard marka 25 me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20% me çimento: gëlqere: rërë në raporte 1: 0,5: 5,5. Gëlqere e shuar 92 lt, çimento 300, 212 kg, rërë 1,22 m³ .

Llaç bastard marka 15 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento, gëlqere, rërë në raport 1: 0,8: 8. Gëlqere e shuar 105 lt, çimento 300, 144 kg, rërë 1,03 m³.

Llaç çimento marka 25 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me çimento: rërë në raport 1:2.

34 - Panele sanduiç me aksesore

Element me panele tip sanduiç do të jetë i përbërë nga:

- Mbështetja metalike, Izolim, Gomina e vetë elementit, Ngjitës adesive

1-Mbështetja metalike:

- Galvanizimi i hekurit bëhet sipas normave të EN 10147/10142; Hekur i lyer paraprakisht me sistem mbulimi e parashikuar sipas studimeve duke plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuar; Hekur i galvanizuar me shtresë mbulesë plastike; Alumin; Bakër i pastër dhe të tjera.

2-Izolimi:

Përdorim lënde termoizoluese polyurethane ose polyisocyanurate, i shkrirë me flakë duke përfutur një adezion perfekt tek mbështetja metalike dhe duke lejuar të fitohet, nëse kërkohet, reaksioni i zjarrit, në përputhje me standartet e kohës të ISO. Densiteti mesatar: 35 – 40 kg/m³. Koeficienti termik: Qelizat e mbyllura: 0,0195 Kcal/mh gradë Celsius > 95 % (jo- hygroscopic).

3-Toleranca Dimensionale:

- Lartësia e brinjës: + 1 mm; Gjerësia (1000 mm) + 2 mm; Gjatësi : + 10 mm; Devijimi Squareness: ≤ 0,5 % të gjerësisë së përdorshme, Përkulja në gjatësi: ≤ 2 mm/metër, Camber: ≤ 1 e gjatësisë, Valëzimi i majave: + 2 mm në 500 m; Trashësia e paneleve: + 2 mm e trashësisë nominale mbi të gjithë sipërfaqen.

4- Adesion:

Disa zona të fleteve jo- adhesive, në kufi të 0,5% të të gjithë sipërfaqes së panelit nuk do të konsiderohet si një difekt.

35, 36 - Përcjellës PPV 2x1.5 mm dhe 2x2.5 mm

Telat dhe kabllot do të plotësojnë kërkesat e aplikueshme për llojin e izolimit, veshjes, dhe përcjellshmërinë e specifikuar. Telat dhe kabllot e prodhuar më shumë se 12 muaj para datës së dorëzimit të saj në vend nuk do të përdoren.

Kodi i ngjyrave: Sigurimi i kodit të ngjyrave për të gjitha kabllot e tensionit të ulët si në vijim:

- Faza 1 - e zezë
- Faza 2 - e zezë
- Faza 3 - kafe
- Neutral N - blu e lehtë
- PE mbrojtës (Toak) - të verdhë / të gjelbër

37, 38 - Pllaka dhe plintuese h = 10 cm

Pllakat do të jenë të dimensiveve 31.6 x 31.6, gres porcelanato një-brumëshe, luçidato, por me dizeno që të imitojë mermerin ose granitin, pra jo monokrome. Koeficienti i marrjes së ujit do të

jetë < 3 %, pra pllakë të klasës së I-rë. Pllakat dhe plintuset do të plotësojnë kriteret teknike sipas STASH 532-61. Plintuset do të kenë të njëjtën ngjyrë dhe material si pllakat dhe me trashësi 1.5 cm.

39 - Prajmer

Prajmeri është material që përdoret për h/izolime dhe hyn në bojërat bituminoze dhe është përzierje e bitumit naftor tip 3 me benzine ose vajguri në masën 50 %, të secilit përbërës.

40 - Rërë e larë

Rërë e larë është nxjerrë nga depozitat e përmytura duke përdorur pajisje hidromekanike. Teknologjia ju lejon të grumbulloni një përzierje pa asnjë papastërti dhe përbërës të panevojshëm. Ky material do të përdoret në prodhimin e llaçeve.

Kriteret teknike që duhet të plotësojë rëra e larë për llaç janë sipas STASH 505-73.

41, 42 - Stuko

Stuko patinimi është material i përbërë nga çimento e bardhë, gëlqere e hidratuar, pluhur mermeri i bardhë, rezina dhe aditivë specialë. Duhet të karakterizohet nga një punueshmëri, hapje e lehtë dhe parrëshqitshmëri vertikale gjë që lehtëson aplikimin nëpër sipërfaqe vertikale. Duhet të lejojë një trashësi nga 0 deri 3 mm për çdo dorë. Duhet të fërkohet lehtësisht me letër zmerile dhe të japi një rifiniturë të lëmuar. Duhet të jetë konform normës EN - 998-1. Stuko pllakash është material me bazë çimentoje, e modifikuar me polimerë, me mpiksje të shpejtë. Duhet të ofrojë rezistencë të lartë mekanike, qëndrueshmëri të shkëlqyer të ngjyrës dhe aftësi të lartë ujëlarguese. Duhet të ofrojë një sipërfaqe përfundimtare të lëmuar dhe me shkëlqim. E përshtatshme për gjerësi fuge deri në 8 mm.

Karakteristika kryesore:

- pH : 12
- Temperatura e punës : nga +5 gradë C deri në +35 gradë C
- Forca ngjitëse në beton : $\geq 0,5 \text{ N/mm}^2$

43 - Teknofix

Do të përdoret si material ndihmës h/izolues. Është material në formë pluhuri me bazë: çimento, gëlqereje, rërë me granulometri të seleksionuar, rezinash sintetike hidrofobike dhe aditivësh specifikë.

- Karakterizohet nga hapje dhe punueshmëri mjaft e mirë që lehtëson aplikimin e produktit si në suportet e mbushura me llaç tradicional apo të parapërgatitur.
- Kohë e gjatë e punueshmërisë, ngjitje shumë e mirë me suportin dhe rrafshim shumë i mirë i sipërfaqes. E aplikueshme për trashësi deri në 3 mm

Të dhëna teknike (Në 23⁰ C dhe 50 % U.R)

Duhet të jetë i padjegshëm, të ketë dendësi të përzierjes 1.82 gr/cm^3 ; pH i përzierjes 12
Temperatura e aplikimit $+5^0 \text{ C}$ deri $+35^0 \text{ C}$. Rezistencë në shtypje $\geq 15,0 \text{ N/mm}^2$. Rezistenca në
përkulje $\geq 3,5 \text{ N/mm}^2$.

44 - Tel bari

Telit i bëhet prova me këputje sipas rekomandimeve të standartit SAE 1006 dhe SAE 1008
Duhet të jetë lehtësisht i punueshëm dhe me diametër $\varnothing = 1.2 \text{ mm}$

45 - Tel xingato

Ky material prodhohet prej çeliku të markës SAE 1008 dhe SAE 1010. Klasifikimi i Telit të
Zinguar bëhet në bazë të formës:

- Në gjatësi nga 0.6 mm deri në 2.2 mm

Duhet të ketë këto cilësi:

Shmangia nga forma rrethore e telit dhe shtresë të zinguar jo më shumë se $0.2 \div 0.6$ mikron.

Kufiri i qëndrueshmërisë dhe perberja kimike e telit sipas standarteve: SAE 1006 dhe SAE 1008

Në të gjithë sipërfaqen e telit nuk lejohen dëmtime, këputje dhe ndryshk.

Në ambalazh vendoset etiketa me përmbajtje: - Shoqëria Prodhuese - Pesha neto - Data e prodhimit
- Firma e kontrollorit të cilësisë.

46 - Tretës boje

Tretesi i bojës (hollues) transparent shërben për të holluar bojërat me bazë vaji.

47 - Tubo plastike

Tubat fleksibël duhet të jenë të tipit DL 44 Range (NF Range) për korridoret dhe /ose i tipit DL 50
Range (BR PVC Range) për dhoma të prodhuara nga GEWISS-ITALY ose pranohet një tjetër i
ngjashëm sipas standarteve përkatëse të mëposhtme: • Përputhja me standartet: CEI 23-32. •
Materiali PVC. • (Rezistenca) Qëndrueshmëria e izolimit: $100 \text{ M}\Omega$ • Shkalla IP: IP40 •
Qëndrueshmëria ndaj goditjeve: IK08

48 - Zhavorri

Zhavorri duhet të plotësojë këto kushte:

- Indeksi i plasticitetit nuk duhet të kalojë 10
- Nuk duhet të përmbajë grimca me përmasa mbi $2/3$ e trashësisë së shtresës, në sasi mbi 5%.
- Nuk duhet të përmbajë mbi 10% grimca të dobëta dhe argjilore

a- Indeksi i plasticitetit

Indeksi maksimal i Plasticitetit (PI) i materialit duhet të jetë jo më shumë se 10.

b- CBR (California Bearing Ratio) minimale duhet të jetë 30%.

c- Kërkesat për ngjeshjen

Në vendet me densitet te matur në gjendje të thatë të shtresës së ngjeshur, vlera minimale duhet të jetë 95% e vlerës së Proktorit të Modifikuar.

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Zerat e materialeve objekt prokurimi qe kerkohen, per te cilat do te ofertohej me cmim per njesi, dhe do te shërbejnë për vlerësimin e ofertes ekonomike, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i materialit	Njësia
1	Allçi	kg
2	Astar	kg
3	Beton C 7/10	m ³
4	Beton C 12/15	m ³
5	Beton C 16/20	m ³
6	Binar druri	m ³
7	Bitum M3 (lëng)	kg
8	Blloqe betoni 25x20x40 cm	copë
9	Bojë antiruxho	kg
10	Bojë hidroplastike importi	kg
11	Bojë çimentato	kg
12	Bojë vaji	kg
13	Çelësa brenda murit	copë
14	Çimento ndërtimi	kg
15	Dërrasë armatimi (Kallëpe)	m ²
16	Dritare duralumin	copë
17	Dyer duralumin	copë
18	Gaz i lëngshëm	lit
19	Gëlqere e shuar	kg
20	Gozhdë	kg

21	Gozhdë betoni	kg
22	Gozhdë me gominë për llamarinë (kapëse llamarine)	copë
23	Gurë kave	m ³
24	Hekur beton > Ø 12 mm	kg
25	Hekur beton Ø 6 mm	kg
26	Karton katërma e graniluar $\delta = 4\div 5$ mm	m ²
27	Kol	kg
28	Konstruksione të thjeshta metalike	kg
29	Kuadër ndricimi (Automat 220 V)	copë
30	Kulmore llamarine	ml
31	Llaç bastard M-25	m ³
32	Llaç M-15	m ³
33	Llaç M-25	m ³
34	Panele sanduiç me aksesore	m ²
35	Përcjellës (Tel elektrik) PPV Ø 2x1.5 mm	ml
36	Përcjellës (Tel elektrik) PPV Ø 2x2.5 mm	ml
37	Plinduese grez h =10 cm	ml
38	Pllaka grez 40x40 cm	m ²
39	Prajmer (emulsion) bitumi	lit
40	Rërë e larë	m ³
41	Stuko muri	kg
42	Stuko patinimi	kg
43	Teknofix	kg
44	Tel bari	kg
45	Tel xingato 3÷4 mm	kg
46	Tretës boje (Neft)	lit
47	Tubo plastike	ml
48	Zhavorr lumi	m ³

Afatet e levrimit :

Afati i marreveshjes kuader eshte nje vit nga lidhja e marreveshjes dhe kontratat do te lidhen pas cdo minikonkurimi sipas afateve te percaktuara nga AK, dhe sipas nevojave periodike per materialet ndertimore objekt prokurimi.

Evidentimi i kërkesave për blerjen e artikujve sipas tabelës së mesipërme, do të bëhet në mënyrë periodike nga autoriteti kontraktor në varësi të nevojave që do të ketë për këto zera.

Procesi i rihapjes së konkurimit për lidhjen e kontratës do të zhvillohet sa herë që do të lindë nevoja për këto materiale dhe mallra.

Kriteri i përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër, në fazën e rihapjes së konkurimit do të jetë çmimi më i ulët.

Vlerësimi i ofertës do të bëhet duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi.

Çmimi më i ulët do të jetë vlera totale e të gjitha çmimeve për njësi të artikujve të kërkuar.

Por në çdo rast ofertuesit nuk duhet të tejkalojnë çmimin për njësi të deklaruar në ofertat e shpallura fituese.

Shtojca 7

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimi/kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % se vlera e fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi për përvorjen e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumatat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e parvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 ose të përditësuar, mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një Deklaratë për cilësinë dhe origjinën e materialeve dhe mallrave, objekt i këtij prokurimi.
- 2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një Deklaratë se merr përsipër furnizimin në çdo kohë me shpenzimet e veta të gjitha materialet objekt prokurimi sipas kërkesave periodike të autoritetit kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I:

Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjisllacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjisllacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]
etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për	

ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP- .	
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
